



# REPUBLIKA E SHQIPERISE

Ministria e Ekonomise Publike  
dhe Privatizimit

Drejtoria e Privatizimit te Ndermarrjeve dhe Shoqerive te Mesme e te Vogla

**URDHER**  
Nr 329 Date 7.9 1999

**PER**  
**PRIVATIZIMIN ME ANKAND PA CMIM FILLESTAR TE PAKETES SE**  
**AKSIONEVE SHTETERORE TE SHOQERISE ANONIME**  
**"KALDAJA "DURRES**

Ne baze nenit 2 te Ligjit Nr.8237 date 01.09.1997 "Per disa ndryshime ne Ligjin Nr.7926 date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare" ndryshuar me akte te tjera ligjore, me cilesine e aksionerit te vetem , ne mbeshtetje te Ligjit Nr 8334 date 23.4.1998 " Per privatizimin e shoqerive tregtare qe veprojne ne sektoret jo strategjik , V.K.M. Nr. 446 date 9.7.1998 "Per procedurat e privatizimit me ankand te paketave shteterore te aksioneve te shoqerive tregtare qe veprojne ne sektoret jo strategjik, VKM Nr. 684 date 28.18.1998 "Per nje shtese dhe ndryshim ne VKM Nr. 446 date 9.7.1998 "Per procedurat e privatizimit me ankand te paketave shteterore te aksioneve te shoqerive tregtare, qe veprojne ne sektoret jo strategjike, VKM Nr 405 date 31.8.1999 "Per procedurat e privatizimit me ankand pa cmim fillestar te paketave shteterore te aksioneve te disa shoqerive tregtare qe veprojne ne sektoret jostrategjik, VKM Nr 407 date 31.8.1999 "Per privatizimin me ankand pa cmim fillestar te paketave shteterore te aksioneve te disa shoqerive tregtare"


**Urdheroj:**

1-Te privatizohet me ankand, pa cmim fillestar paketa shteterore e aksioneve te "Kaldaja " Sh.A Durres , sipas V.K.M. nr 405 date 31.8.1999 , dhe V.K.M.nr 407 date 31.8.1999.

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE TIRANE  
NOTER ARTEMISA MEÇAJ

Nr. 309..Regj.Nr. 335..Kol.

Nr. 3542 Prot. (AKP).



Tirane, 25 Nentor 1999

**KONTRATE SHITJE  
PER PAKETEN SHTETERORE TE AKSIONEVE PREJ 51 % TE  
"KALDAJA"SH.A.DURRES**

Sot, me date 25.11.1999 njemije e nenteqind e nentedhjete e nente, ditën e enjte, ne Agjensine Kombetare te Privatizimit Tirane, perpara meje noterit te Dhomes se Noterise Tirane, Z. Artemisa Meçaj hartohet kontrata e shitjes se paketes se aksioneve prej 51 % e barabarte me 35.575 (tridhjetë e pese mije e peseqind e shtatedhjete e pese) aksione ne "Kaldaja" Sh.A.Durres e regjistruar ne Gjykatën e Rrethit Tirane me Vendimin Nr.21538 date 23.06.1999

midis paleve te cilat u muaren vesh si me poshte :

**Neni 1 - Palet**

1.1 *Palet shiteses:* Agjensia Kombetare e Privatizimit Tirane e perfaqesuar nga Drejtori i Pergjithshem i saj, Z. Qirjako Theodhori.

1.2 *Palet blereses:* Z. Ilir Verdha i biri i Saliut dhe i Ikbales i lindur ne Tirane me 31.01.1955 me numer pasaporte 0423018 madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, me adrese banimi : Lagja Nr.2, Rruga "Karl Topia" Pallati Nr.887 Durres i shpallur fitues ne ankandin e zhvilluar date 26 Tetor 1999 ne Agjencine Kombetare te Privatizimit, i njohur me autorizimin Nr.3102, date 26.10.1999, per kryerjen e pageses se vleftes se plote te paketes shteterore te aksioneve prej 51 % te "Kaldaja"Sh.a., Durres.

1

**Neni 2 - Objekti**